



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROÇEDURAVE

Nr. 8433/Prot.

Tiranë, më 20.01.2025

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 02 , datë 20.01 . 2025

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Lel- Medical" Shpk, me NUIS K81917006T, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për paraqitje dokumentacioni me të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi në procedurën e prokurimit Loti I me objekt: "Blerje aparat alkol testues", të zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit, NIPT, adresa): "Lel- Medical" Shpk, me NUIS K81917006T, me adresë: Rruga e Elbasanit, Vila Nr. 7, Tiranë.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Lel- Medical" Shpk, me NUIS K81917006T, ka nisur bazuar në Vendimin Nr. 1519/2024, datë 29.10.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, dërguar me shkresën Nr. 2329/19 Prot. datë 29.10.2024.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP, ku parashikohet se: "Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 02 datë 20.01 2025, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Lel- Medical" Shpk, me NUIS K81917006T, nga e drejta për të fituar kontrata publike, **për 12 (dymbëdhjetë) muaj** nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.